



“Me kursime të vogla për qëllime të mëdha”

Punimet e fituesve të konkursit për esetë më të mira rreth kursimit
2020






Punimet në vijim janë përzgjedhur si esetë më të mira nga konkursi për ese mbi kursimet për vitin 2020.

Esetë janë punuar nga nxënësit e klasave 6-9, të shkollave fillore të Kosovës dhe shtjellojnë rëndësinë e kursimit për realizimin e dëshirave dhe qëllimeve në të ardhmen.

Esetë në vazhdim janë origjinale, kreative, reale apo imagjinare dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë jetën private të autorit.





Qëndresa Peci, SHFMU "Isa Boletini", Zveçan

Sakrificat ia vlen kur synohet qëllimi i madh

Unë kam dëshirë që në jetë të bëhem dikush dhe të arrij diçka. Ëndrra ime është që të bëhem mjeke, megjithëse e di se shkollimi për këtë profesion kushton. Unë duhet të punoj shumë për këtë kohë pas kohe dhe gjithashtu e di se duhet edhe të mësoj shumë. E për ta arritur këtë duhet sakrificë e madhe duhet t'ia mohoj vetes shumë qejfe fëmijërore për t'ia arritur synimet e mia. Mbi të gjitha duhet të kem vullnet të hekurt.

Gjendja me financa në familjen time është e mirë, por unë jam ende e vogël për të punuar dhe nuk mund të punoj ende askund, kështu që duhet t'ia ruaj dhe t'ia kursoj pak paratë duke i tubuar, që kur të rritem të studioj dhe t'ia përballoj vetë disa shpenzime.

Unë nuk jam fëmija i vetëm në familje, sepse unë kam edhe dy vëllezër dhe një motër. Unë jam fëmija më i madh dhe si çdo fëmijë tjetër që është në krye të vëllezërve apo motrave edhe unë dua të jem model i mirë për ta. Shpresoj që ta arrij këtë, sepse çdon ditë mundohem që me veprimet e mia të matura t'ia bëj edhe ata të më ngjajnë.

Gëzohem shumë kur i dëgjoj prindërit të thonë nganjëherë "Urojmë të bëheni edhe ju kështu si Qëndresa".

Mënyra se si i kursoj unë paratë është se kur ka festa, secili familjar i afërm më jep para. Unë ato para i mbledh dhe e kam një kuti ku i lë të gjitha. Në fund të vitit unë e hap kutinë dhe e shikoj se sa para i kam mbledhur gjatë tërë vitit. Pastaj unë i llogaris se sa para kam pasur vitin e kaluar dhe sa para kam tash. Gjatë çdo viti, tash pesë vjet, unë grumbulloj para edhe pse asnjë vit nuk grumbulloj para me shumë të njëjtë. Nganjëherë grumbulloj më pak e nganjëherë më shumë.

Unë di të vizatoj shumë mirë. Nuk jam një piktoresh profesionale, mirëpo me këtë aftësi që kam do të mundohem të fitoj para për qëllimin tim në jetë. Mendoj ta rregulloj një dhomë pune ku mund t'ia lë vizatimet, t'ia grumbulloj dhe pastaj ta hap një ekspozitë dhe t'ia shes ato. Do të grumbulloj para prej tyre dhe do t'ia ruaj, pastaj shkollimin e nis me to.

Paratë nuk do t'ia shpenzoj për gjëra të shtrenjta, vetëm duhet t'ia blej disa fleta dhe ngjyra më të mira për pikturim dhe të tjerat i ruaj. Paratë nuk do t'ia shpenzoj vend e pa vend, por me to mund ta rregulloj shtëpinë duke e lye jashtë, që dimrat t'ia kalojmë më lehtë. Ndoshta do të arrij që të sigurojmë edhe nxehjen qendrore që të ngrohet çdo pjesë e shtëpisë (salloni, dhomat e fjetjes, korridori). Nëse kursoj sa duhet, mund ta gëzoj edhe dikë tjetër ndonjëherë, si vëllain tim të vogël, duke ia blerë ndonjë dhuratë për ditëlindje ose herë pas herë duke i dhuruar ëmbëlsira të ndryshme.

E cila motër nuk mundohet ta lumturojë vëllain?


Me këto kursime mund t'ia blej gjërat që më nevojiten gjatë shkollimit tim, si p.sh. libra, fletore edhe sende të tjera. Nganjëherë them me veten se mos i kam synimet shumë të mëdha, se prindërit me katër fëmijë mundohen t'ia barazojnë shpenzimet për secilin, kurse unë si studente e mjekësisë do të kisha kërkesa të mëdha. Por unë shpresoj të jem e suksesshme në shitjen e pikturave, duke qenë se ekspozitën planifikoj ta bëj në një vend publik të hapur dhe ta shkruaj me shkronja të mëdha moton: "BLI NJË PIKTURË, NDIHMOJE NJË MJEKE TË ARDHSHE".

Kur t'ia mbaroj studimet në Kosovë, ndoshta mund të fitoj bursë që të shkollohem jashtë shtetit.

Pasi ta mbaroj shkollën, mund të punoj dhe të kujdesem për familjen që të kemi një jetë më të mirë sesa që e kemi tash.

Kur t'ia kem arritur këto qëllime, do ta kujtoj me nostalgji të shkuarën duke u mburrur për veten si arrita ta përmbush ëndrrën time me disa kursime të vogla.

Familja ime po ashtu do të ishin krenarë me mua që sakrificat që bëra ia vlejten për të përmbushur qëllimet e mëdha.





Erona Peci, SHFMU “Isa Boletini”, Zveçan

Një bibliotekë për fshatin tim

Unë jam 13 vjeçare dhe kam shumë ëndrra në jetë. Kushtet e mia të jetesës janë të mira, por unë e paramendoj një të ardhme tjetër. Kam dëshirë të mësoj e të arrij diçka në jetë që të bëhem një vajzë e pavarur. Babai dhe unë kemi plane të mëdha për jetën time. Ai e di se unë kohës së fundit kam filluar të kursej para në një kuti që e kam ndërtuar vetë me paketa e me ngjitës, se mendoj që kështu nis të kursej seriozisht e jo të shkoj nëpër dyqane të zgjedh se cila kuti është më e mira apo të mundohem të shtyhem me shoqe se kush e ka kutinë e kursimeve më të bukur. Babi mendon se unë planifikoj që më kursimet e mia ta ndërtoj një bibliotekë të vogël në fshat.

Fshati im, fshati Zhazhë, është një fshat i vogël në veri të Kosovës. Nuk ka diçka më shumë ose më pak se fshatrat e tjera të Kosovës. E jetojmë një jetë të thjeshtë si shumica e banorëve në shtetin tonë. Përveç familjes së shëndoshë si gjëja më e shtrenjtë që mund ta ketë një fëmijë i lumtur, mua më lumturojnë shumë dy shoqet e mia të ngushta, Albina dhe Qëndresa.


Me dy shoqet e mia bisedojmë gjithçka. Ato kanë filluar ta mendojnë edhe profesionin e ardhshëm dhe janë të vendosura shumë që do të arrijnë të bëhen njëra mësuese e tjetra mjekë. Unë jam e luhatshme dhe nuk jam përcaktuar deri më tash se cilin profesion është më i përshtatshëm për mua. Vetëm babi dhe dy shoqet e mia e dinë qëllimin tim në jetë, sepse unë njëmend planifikoj ta ndërtoj një bibliotekë në fshatin tim. Nëse do ta ndërtoja këtë bibliotekë, do t’i ndihmoja të gjithë fëmijët e fshatit që të ecin përpara në rrugën e pafundme të dijes. Ta humbasin veten në botën e leximit në plot aventura të personazheve të ndryshme. Me libra të autorëve të mëdhenj e të vegjël të fitojnë dije nga secili nga pak, si është thënia “Pika-pika mbushet pusi” e në rastin tonë pak aty e pak aty do të mbushen plot dije, do të bëjnë gjëra të mëdha kur të mësojnë nga jeta e personazheve dhe do të njohin vende që nuk kanë mundësi t’i vizitojnë.

Nëpër filma kam parë se fëmijët kur duan ta arrijnë një qëllim në jetë mundohen ta bëjnë duke ndihmuar dikë ose duke shitur ëmbëlsira në qytet. Unë e kam zgjedhur një mënyrë të ngjashme për të tubuar para. Në secilën nga tri stinët e para në fshatin tonë dalin bimë e pemë të shumta. Në pranverë e në vjeshtë, kur bie shi, dalin kërpudhat dhe i mbledh bashkë me motrën time që t’i shesim. Në stinën e verës mbledhim lule të shtogut dhe lule të blirit që shërbejnë për çajra mjekësor. Edhe manaferrat janë frutat që bëhen shumë në vendin tonë. I mbledhim edhe ato kur piqen në verë dhe fitojmë para, shumicën prej tyre i kursej. Shpresoj se do të arrij që ta realizoj planin tim për ndërtimin e bibliotekës në fshatin tim.

E kam vizatuar projektin, është një skicë shumë e bukur. Ku i dihet, ndoshta këto vizatime do të më ndihmojnë të përcaktohem për profesionin tim kur të rritem. Mbase një arkitekte.

Por cilido qoftë profesioni im, unë do të përpiqem gjithsesi që ta ndërtoj bibliotekën në fshatin tim.

OPEN
LIBRARY





Erina Musliu, SHFMU "Mihal Grameno", Fushë Kosovë

Me kursime të vogla, për qëllime të mëdha

Të gjithë kemi ëndrra dhe dëshira, që dëshirojmë t'i realizojmë! Edhe unë kam të tilla, madje kam shumë!

Në raftin e dhomës sime që ndodhet në anën e djathtë pranë derës, kam një tas që duket sikur është i mbështjellë me një kartëmonedhë prej letre.

Nga jashtë, ky tas nuk është edhe aq i bukur, por brenda tij, ai mbanë copëzat e ëndrrave të mija. Në të, unë çdo ditë hedh nga një monedhë euroje apo centësh. Secila prej këtyre monedhave metalike, është një copëz e ëndrrës sime për të cilën kam zbuluar para tre vitesh se nuk mund të realizohet pa kursyer!

Dëshira e madhe që kam për të studiuar jashtë Kosovës kur të rritem, bën që ky tas të mbushet deri më tash dy herë me monedha prej metali. Por me mbushjen e tasit me monedha, dëshirat vetëm sa po shtohen e ëndrrat vetëm sa po bëhen gjithnjë e më të mëdha.

Megjithatë, është shumë bukur të ëndërrosh!

Kur jemi të vegjël, kërkojmë nga prindërit shumë gjëra, pa vrarë mendjen për gjënë më të vogël. Kërkojmë lodra të shumta, veshmbathje të ndryshme, mjete shkollore apo pajisje teknologjike. Si fëmijë, shpesh nuk dimë të dallojmë nevojën nga dëshira. E kjo mosdija jonë në njërin anë, dhe vullneti i prindërve që të na plotësojnë dëshirat tona, vetëm sa shkakton shpenzime të shumta. Që ne të kemi ato që duam, prindërit sakrifikojnë shumë nga nevojat e tyre! Duke shpenzuar në gjëra të panevojshme, harrojmë që atje jashtë, në këtë botë të vështirë e të egër, shpesh e pamëshirë, prindërit nuk e kanë të lehtë t'ia dalin.

Por çfarë mund të bëjmë ne?!

Asgjë do të thoshte dikush sepse jemi të vegjël!

Përkundrazi, unë mendoj se do të bënim shumë që t'i ndihmojmë prindërit, e në këtë mënyrë do të ndihmonim edhe veten që ëndrrat tona të mos mbesin vetëm dëshira! Për këtë, kursimi është zgjidhja!

Pse të mos kursejmë paratë që na dhurojnë prindërit tanë për festa? Pse të mos kursejmë nga dhuratat e ditëlindjeve?

Edhe pse nuk janë shumë, nëse kursehen dhe bëhen së bashku, një ditë do të do të jenë mjaftueshëm për të plotësuar një dëshirë apo një ëndërr.

Plotësimi i dëshirave tona nuk mund të vijë fluturimthi.

Ato vijnë vetëm duke kursyer pak nga pak, derisa një ditë, ato të plotësohen sikurse tasi im i kursimeve që është gati të mbushet për herën e tretë.

Prandaj, tani që po rritem e kuptoj edhe më mirë se nuk ka ëndërr apo dëshirë të madhe apo të vogël që nuk mund të realizohet.

Krejt çfarë duhet është qëllimi, vullneti e kursimi për të realizuar atë që secili ëndërron!



*live
your
dream.*



Enda Imeri, SHFMU "Ibrahim Rugova", Podujevë

Me kursime të vogla për qëllime të mëdha

Isha vetëm gjashtë vjeçare kur pranova për dhuratë një arkë të vogël. Atëbotë nuk kisha njohuri për funksionet që kryente ajo, megjithatë ndoshta ngjyrat e bukura të saj më bënë kureshtarë t'i kushtoj vëmendje. Nëna më tha se aty mund të mbledh para.

Kështu si një fëmijë kur ka diçka të re, u bëra shumë kureshtarë për të praktikuar këtë mënyrë të të grumbulluarit para. Sa herë që dikush më jepte para, unë i vendosja në arkën time të vogël. Fillimisht zhurma të cilën e dëgjoja sa herë lëshoja paratë, ishte ajo që më bënte më shumë përshtypje. Por shprehia të cilën e kisha krijuar, filloi të më impresiononte pasi që nisa të planifikoj se si do t'i shpenzojë këto para.

Familjarët e mi të cilët më jepnin përkrahje, filluan të më tregojnë pse është e rëndësishme që të kursej.

Unë kuptova që të menduarit për të ardhmen është zgjidhja më e mirë, pasi që kështu mund t'i ndihmoja familjes por edhe vetes në studime.

Normalisht që jo çdoherë është e thjeshtë që të vendosësh që paratë që i ke, t'i kursesh, pasi që në një periudhë kur të rinjtë kanë mundësi që të shpenzojnë paratë brenda ditës, në forma të ndryshme, t'i duhet të mendosh për të ardhmen. Mirëpo qëllimi im është që të kem mundësi të shkollohem në mënyrë sa më të mirë, pasi që kjo është mënyra më e sigurt që ta përmirësoj jetesën time dhe të prindërve të mi.

Do të doja që përmes kursimeve të mia, të përparoj në mënyrë që i gjithë mudi i prindërve të mi të shpërblehet dhe një ditë të shohin se kjo është përveç e mirë në aspektin financiar, na ka bërë më të mirë edhe si njerëz, pasi që kemi krijuar shprehi të mira të cilat ndikojnë pozitivisht.





Erdonit Jusufi, SHFMU " Dëshmorët e Kombit", Kamenicë

Me kursime të vogla për qëllime të mëdha

Dëshira, vullneti e ëndrrat e fëmijëve nuk mungojnë asnjëherë. Edhe unë, si çdo fëmijë në Kosovë por edhe më gjerë, kam pasur dhe vazhdoj të kam shumë ëndrra, ëndrra me të cilat zgjohem çdo mëngjes e bie të fle çdo mbrëmje. Ndoshta për ne është e vështirë të themi, e qe besa edhe nuk duam të shprehemi, sepse nuk duam që prindërit tanë të preken nga fjalët apo veprat tona, duke e ditur që edhe ata kanë dashur dhe duan të na i plotësojnë ëndrrat, mirëpo është faktori varfëri që na i pamundësoi ato.

Kemi vuajtur shumë, ndoshta edhe ndonjëherë kemi mbetur pa ngrënë, por asnjëherë nuk do të përsëritet kjo më tek ne, sepse unë do të vazhdojë jetën me parimin dhe fjalët që më ka thënë babai "Djali im, puno me të gjitha mundësitë e tua, puno ndershëm dhe me vullnet, mirëpo mos e harro gjënë kryesore se gjithmonë lë vend për kursime, sepse ajo se çfarë je tregohet në atë se si i menaxhon gjërat e tua..!".

Fillimisht mendoja se si të kursej, kur të hyrat janë shumë të vogla e ndoshta edhe minimale, e madje shpeshherë e pyesja babain se si arrinte që me kaq shumë shpenzime të i'a dilte mbanë, e të na i plotësonte kushtet elementare për jetesë?!, përgjigja e tij ishte gjithmonë e njëjtë e që lidhej me thënien, rrëfimin që ma kishte treguar më parë, e të cilin vazhdonte të ma rrëfente... Pasi u rrita pak dhe fillova të kuptojë jetën sado pak, i vendosa vetes një kusht, se çdo ditë që babai ose ndonjë i afërm i imi do të më jepte para për ti shpenzuar, gjysmën e tyre do ti mbaja të fshehur ose më mirë të them t'i kurseja. Tashmë e kisha vendosur, çdo ditë hedhja para në një arkë të vogël kursimi. Ditët, javët e muajt iknin dhe unë vazhdoja me të njëjtin trend. Edhe pse unë si fëmijë isha shumë kurreshtar të shihja se sa para janë grumbulluar, nuk doja ta thyeja rregullin që i kisha vendosur vetes dhe nuk e hapa asnjëherë arkën. Krejt papritur, një natë dëgjova një bisedë në mes të babit dhe nënës në kuzhinë, e parandjeva se diçka nuk shkonte... e si kurreshtar shkova të i pyesja.

Babai rezistoi dhe nuk më tregoi për situatën, mirëpo nënës nga dhembja dhe dëshpërimi i rrëshqiti nga goja, më tha se kishim mbetur pa ushqim në shtëpi dhe nuk kishim para as për edhe një kokërr bukë. Unë u shtanga, por nuk u brengosa shumë sepse shpejt shkova tek dhoma ime, mora arkën të cilën e kisha fshehur nën dollap, dhe ia dhurova babait. Ai, i habitur dhe i heshtur, më vështronte por nuk dinte se çfarë të më thoshte, kur nëna më në fund më pyeti se çka është ajo dhe se nga e kisha marrë..?!. Me krenari u përgjigja, këto janë disa kursime të miat, e të cilat dua që sot ti ndaj me ju, e posaçërisht me babain, i cili më dha një mësim të cilin sot e kuptova plotësisht- se kursimi është shumë i rëndësishëm, dhe miku më i mirë i njeriut për kohë të vështira.

Ky rrëfim që unë vendosa ta ndaj me ju, më ka ndodhur mua, andaj dua që të gjithë njerëzit e tjerë të fillojnë me kursime, sepse janë gjëja më e rëndësishme për të arritur qëllimet që ia caktoj më vetes.

Tash e tutje, synimi im është që të fillojë kursimet e mia për studime, sepse kam një ëndërr për të ndjekur,

e ajo ëndërr është që të bëhem mjek i shkëlqyer dhe t'i ndihmojë njerëzit dhe komunitetin në nevojë.

Unë jetoj në të tashmen mirëpo gjithmonë mendoj për të ardhmen, andaj edhe shpenzoj sot, por gjithmonë kursej diçka për nesër..!





Adora Alidemaj, Shkolla ISP, Prishtinë

Kursimet

Kurseni para fëmijë, mund të ju ndihmojnë në të ardhmen, kursimi është gjë e domosdoshme për jetë – ishin fjalët e afaristes së re me suksese të mëdha. Por si mbërriti këtu ajo, si ia arriti? Nuk kishte një fillim të mbarë thuhej, por kursimet ishin ato që..... trring trring, erdhi koha për t'u zgjuar.

Përshëndetje, jam Adora Alidemaj, vajzë 13-vjeçare, e cila jeton në Prishtinë.

Jeta sot është bërë e vështirë, nuk mund të shkosh askund pa para, dhe ndoshta e dini edhe ju që paraja nuk fitohet lehtë, por është mike e përditshmërisë sonë, si një hije e jona do thoja.

Dua të blej një bluzë, por momentalisht jam në mungesë të parave, si t'ia bëj? Më pëlqen shumë kjo varëse, por buxheti im s'e ofron këtë bukuri. Këtu heronjtë tanë janë kursimet, janë ato drita që ndrisin në kohë të vështira financiare. Kemi dhe mundësitë tjera si borxhet, por ato nuk harrohen, duhen paguar dikur. Pse të mos ruaj disa para nga blerja javore për ta blerë atë varësen që doja shumë? Apo... jo sepse nuk duhet të kënaqem gjithmonë vetëm gjatë momentit dhe të harroj për të ardhmen. Bëjmë shumë gabime në jetë, por duhet të mësojmë nga ato. Mos menaxhimi i parave është një nga gabimet më të mëdha, sepse s'i dihet jetës, një ditë je në majë, por ditën tjetër nuk mund të gjesh rrugën për fillim.

Sjellja jonë ndaj parave ndikon edhe në lumturinë tonë, kur kemi dhimbje financiare kursimet do të jenë shërimi i plagëve tona.

Një ndryshim të madh bëjnë, apo jo, thjesht duke kursyer ditë për ditë edhe vetëm nga një cent, më vonë do krijohet një bashkësi pozitive, që do mundohet të zbresë minuset, që do të jetë më mirë se asgjë.

Kursimi është mirë të fillohet që nga fëmijëria, të jetë si një mik përkrahës ndaj qëllimeve tona, si ai çelës i hapjes së derës së shkëlqimit të syve tanë nga lumturia. Kërkohet punë edhe vullnet, por të gjitha gjërat arrihen vetëm me pak dëshirë. Mund të fillojmë me një plan, një busullë orientuese, një drejtim nga ana e saktë e kryerjes së punëve.

Shihet se ata që kanë plane kursimi kanë rezultate gjithmonë më të suksesshme.

Fillimisht duhet t'ia krijojmë vetes një rregull, një detyrë shtesë që thotë "do të kursej pa përjashtime, do të jetë normalitet i imi gjatë ditës", kjo mund të ndihmojë në largimin e përtesës për të vazhduar më tutje. Nuk është ide e keqe bërja e dukshme e kursimeve tek vetja, mund të jetë shtim i kurajës për të kursyer më shumë.

Shprehja "shpenzoni më pak se sa fitoni" përmbledhet shkurt me fjalën kursim dhe nuk thuhet kot, sepse ato para të ruajtura do jenë një hap më lart kur ti je duke zbritur poshtë.

Duhet gjithashtu të mendoni e veproni zgjuar.

Pas një kohe të gjatë të ruajtjes së parave, nuk duhen shpenzuar më vonë në gjëra të padobishme nga joshja e tyre apo entuziazmi juaj i ruajtjes gjatë një kohe, sepse ato mund të zhduken përsëri vetëm nga mos zgjuarsia juaj. Duhet të kthehet në vlerë. Duhet kryer të gjitha pagesat në kohën e duhur, kështu nuk do mbetemi në borxhe, si dhe do ishim shembull i duhur i të qenurit i rregullt.

Eh, mbërritëm tek bankat, kasaforta të mrekullueshme për ruajtje të parasë, mur mbrojtës i tyre.

Kanë cilësinë më të lartë në sigurinë e parave, prandaj të gjithë ruajnë paratë tek ato. Por, si fillim është mrekulli mbajtja e një arke kursimesh në shtëpi, mjeti me të cilin shumica e fëmijëve kursejnë.

Gjithashtu marrja e informatave dhe leximi për tema të ndryshme është një plus për motivim, këtë e them nga përvoja, sepse më shtyu që të filloj arkën time të kursimeve.

Mund të shohim se kursimi është një kulturë, një edukatë e treguar në anë pozitive me arritje të qëllimeve, edhe pse nuk do ishte asgjë pa sakrificë e durim, pa kaluar gjithë rrugën për të mbërritur në fund, pa ngjitur të gjitha shkallët për të mbërritur në majë, por në fund të gjitha kalohen me buzëqeshjen që qëndron në fytyrën tënde.

Me kursim ka lumturi, këto fjalë nga goja jonë duhet të dalin, Për një sukses si ky, përtesa e negativiteti duhet të ndalen!





Era Xërxa, SHFMU “Eqrem Çabej”, Mitrovicë

Paraja dhe kursimi

Në kohët e lashta njerëzit përdornin gjësende të ndryshme të cilat i shkëmbenin për të marrë atë që u nevojitej, në atë kohë është edhe vetë fillimi kur idea e parasë daton. Një copë letër e cila përdoret për të paguar diçka, sot është kthyer në gjënë më të nevojshme anë e mbanë botës. Ndonse jo gjithçka ajo është pjesë shumë e rëndësishme e një jete të mirëfilltë. Shumë njerëz vuajnë për të e shumë të tjerë e keqpërdorin. Ajo çfarë ka rëndësi është se çfarë do të bësh ti kur të kesh paranë në dorë?

Kursimi nuk është vetëm ruajtja e parasë, por edhe shfrytëzimi i panevojshëm i gjësendeve të tjera luan rol të rëndësishëm në kursim.

Shembulli 1: Nëse rryma elektrike kursethet atëherë edhe shpenzimi në para do të ulet i cili automatikisht rezulton me kursim.

Shembulli 2: Nëse unë si nxënës e shfrytëzoj një fletore, ngjyrë apo laps në mënyrë racionale atëherë rezultati do të jetë kursimi sepse fletorja, lapsi, apo ngjyra do të zgjasin më shumë dhe nuk do të kem nevojë të shfrytëzoj para në një kohë të shkurtër për të blerë të tjera.

Kursimi është virtyt i cili na bënë njerëz. Ne mundohemi të kursejmë familjen, paratë, të mirat materiale etj. Çdo njeri mund të kursejë.

Ka dy lloje të kursimeve: afatgjata dhe afatshkurtra.

Teknologjia dhe përparimi i saj na ka mundësuar sot shumë mënyra të përfitimit dhe kursimit ndërsa mënyra më tradicionale e kursimit është banka.

Banka është institucion i cili ofron shërbime të shumta të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë. Aty ne mund të hapim llogari të llojeve të ndryshme mirëpo ajo që na nevojitet në këtë rast është llogaria e kursimeve, kjo llogari mund të hapet që në lindje nga prindi/kujdestari ligjor. Kjo llogari nuk është llogari rrjedhëse, sepse aty mund vetëm të deponohen paratë nga prindi/kujdestari për qëllime kursimi dhe mund t'i tërheqim kur të mbushim moshën. Ne në këtë rast kemi bërë kursim afatgjatë.

Përfitimi i këtij kursimi është:

Shembull:

Pas moshës 18 vjeçare unë do të vazhdoj studimet dhe do ti kem të siguruar mjetet e nevojshme për shkollim.

Kursimet afatshkurtra janë ato të cilat ne kursejmë për të blerë rroba, mjete për shkollë apo gjësende të tjera.

Këto kursime ne i praktikojmë gjatë gjithë kohës ndonëse edhe pa vetëdije.

Shembull:

Babai sot më dha 1 euro, mua më nevojiten 0.50 cent ndërsa 0.50 cent e mbetura i kursej për qëllime të njëjta apo qëllime të tjera edhe në ditët në vazhdim.

Ne kursuem 50 cent në mënyrë që t'ua lehtësojmë barrën familjarëve tanë dhe kjo është një vepër e veçantë.

Edhe pse jemi fëmijë dhe ende nuk kuptojmë shumë nga paratë apo menaxhimi i tyre ne mund të mësojmë të kursejmë sepse nga kursimi i parasë së vogël krijohet shumë e madhe.

Këshilla ime për të gjithë njerëzimin është që të kemi kujdes me paranë apo gjësendet e tjera sepse fati ndonjëherë është mizor dhe ne nuk e dimë se çfarë do të sjellë e nesërmja!

Kurse sot që të kesh nesër!





Ema Boqolli, SHFMU "Asdreni", Pejë

Ese mbi kursimet

Kursimet janë pjesë e rëndësishme për të gjithë, sepse paratë e kursyera janë një mjet shumë i rëndësishëm i jetesës për ne. Ka momente në jetën tonë kur paratë nevojiten urgjentisht dhe ne nuk duhet menjëherë që të marrim kredi nga bankat, ose të hymë në borxh tek dikush tjetër, por të kemi para të kursyera dhe ato të përdorim atëherë kur vërtet na duhen me patjetër.

Kursimet të ndihmojnë për të krijuar një shprehje të shpenzimit të parave në mënyrë të drejtë dhe na bëjnë që të kuptojmë me mirë dhe më shumë për vlerën reale të parasë. Pra, ne duhet të mendojmë për të ardhmen tonë, sepse e ardhmja jonë na kërkon që krahas jetës së përditshme për të zhvilluar atë, do të kemi nevojë edhe për para të kursyera dhe jo vetëm të kërkojmë para hua nga dikush apo të marrim kredi në banka.

Në kuadër të edukimit financiar dhe me qëllim të shënimit të ditës botërore të kursimeve e cila organizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me moton e Ditës Botërore të kursimeve "Me kursime të vogla për qëllime të mëdha", dua të them se në parim me kursimet nuk përfiton ai që fiton shumë, por përfiton ai që të ardhurat din edhe t'i kursej.

Gjithçka që fitohet duhet të ruhet dhe mos të shpenzohet për qëllime të kota. Nëse ne punojmë, fitojmë, shpenzojmë dhe nuk kursejmë atëherë nuk kemi bërë asgjë, duhet të dimë sa shpenzojmë dhe si t'i shpenzojmë ato para që i kemi fituar.

Nëse flas për kursimet personale, unë mund të ju them se edhe pse ende jam në moshë të re, pra ende paratë nuk i fitoj vet, nuk kam ndonjë shumë të madhe të parave të kursyer. Por unë, për çdo cent që e kam pranuar e di saktë nga kush dhe si i kam pranuar. Shumicën nga to i kam të dhuruara nga familjarët dhe të afërmit e mi me rastin e ditëlindjeve të mia, sukseseve në shkollë, ngjarjeve dhe festave të ndryshme në familje. Gjithashtu, prindërit na kanë treguar se për çdo muaj, nga paga e tyre e ndajnë një shumë të caktuar në një llogari të kursimeve që e kanë hapur si të përbashkët për mua, për vëllain dhe për motrën time. Prindërit nuk na kanë treguar se sa është ajo shumë.

Por unë po mendoj që me ato paratë e mia që po i kursej vet, dhe me ato që po i kursejnë prindërit për mua ose për neve, do t'i shpenzoj ose përdor vetëm aty ku kam nevojë, si për shkollim në përgjithësi dhe pse jo edhe për ndonjë investim në ndonjë punë ose biznes që dua vet ta hap kur të rritem.

Dhe sigurisht kur ta arrij një moshë të caktuar, për shembull kur ta përfundoj fakultetin, unë do të kem mjete të mjaftueshme nga kursimet për ta filluar jetën time si e pavarur dhe dalëngadalë ta krijoj kapitalin tim, për t'ju ndihmuar prindërve dhe atyre që kanë nevojë e gjithashtu të kursej mjete, për vete dhe për të ardhmen time.





Hena Perjuci, SHFMU “Eqrem Çabej”, Mitrovicë


Me kursime të vogla për qëllime të mëdha

Çdo gjë fillon qysh në moshat e hershme, me arkat individuale të kursimeve, që dikur i hapnim çdo ditë duke numëruar me kujdes çdo qindarkë, me shpresë se një ditë do të jenë të mjaftueshme për arritjen e qëllimeve tona të vogla. Gradualisht arka mbushej, e prindërit kërkonin t'i depononim në llogaritë bankare, gjë që se imagjinoja dot, paratë e mia që i kurseja me muaj të përfundonin në bankë, por vitet kaluan dhe tashmë e kuptova se për qëllime të mëdha do të duhet t'i deponoj paratë në bankë!

Qëllimet e mëdha qëndrojnë pas shprehive dhe zakoneve të përditshme. Edukimi financiar është i rëndësishëm për çdo grup-moshë, por kryesisht për fëmijët. Edhe pse ne jemi në moshë të re, duhet të jemi të vetëdijshëm që shprehite e vogla sot, ndërtojnë një të ardhme të sigurt. Sado të mëdha që të jenë qëllimet tona, ato në jetë paraprihen nga kursimet e vogla që mund të na ndryshojnë të nesërmen. Kursimet e hershme janë përgatitje për jetën, për vendimmarrje individuale ose grupore, dhe thjesht janë aftësi financiare. Qëllimi im është që të studioj në shkollë të specializuara jashtë vendit, mirëpo ato njohuri t'i sjellë me vete kur të kthehem që t'i shërbej atdheut tim, Kosovës.

Mirëqenia dhe e ardhmja ndërtohen në themel me edukimin financiar në moshë të hershme, sepse pavarësia individuale dhe perceptimi i së ardhmes sonë nxisin guximin për vazhdimin e realizimit të ëndrrave, të cilat janë në dorën tonë.

BËJ DIÇKA SOT, QË E ARDHMJA TË TË FALËNDEROJË NESËR!





Etrid Thaçi, SHFMU "Metush Krasniqi" fshati Rogoçicë, Kamenicë

Me kursime të vogla për qëllime të mëdha

Thonë që paraja nuk është gjithçka, por edhe pa para nuk mund të bëjmë gjithçka. Andaj themi se paraja është mjaft e rëndësishme për të tashmen dhe të ardhmen tonë, për të pasur një jetë më të mirë dhe më të lehtë.

Neve na nevojiten paratë dhe nëse e kuptojmë rëndësinë dhe vlerën e parasë atëherë duhet ta kuptojmë se rëndësia e kursimeve është e domosdoshme sidomos në vendin ku ne jemi duke jetuar.

Çdo vit që ne po rritemi po e kuptojmë rëndësinë e parasë, duke parë vështirësitë e prindërve tanë që ne po kalojmë çdo ditë.

Kur isha më i vogël, nuk e kam ditur se çka shërbejnë paratë, por kur dikush na jepte para, ne u gëzonim por pa e kuptuar mirë rëndësinë e saj. Ndërsa tash që jemi më të rritur dhe po ballafaqohemi çdo ditë me vështirësi të ndryshme që po i kalojmë dhe do të na përcjellin edhe në të ardhmen, ne duhet të kuptojmë rëndësinë e parasë.

Gjatë kalimit të viteve, prej një klase në tjetër në shkollë, ne kemi mësuar edhe për rëndësinë e parasë sepse ne si fëmijë, dimë të harxhojmë më së shumti para.

Por e rëndësishme është, që ne të rritemi duke u edukuar e mësuar edhe për kursimet e parave si dhe rëndësinë e tyre që ka për të ardhmen tonë. Pra paraja na nevojitet kudo që shkojmë.

Unë qysh si i vogël kam kursyer para në mënyra të ndryshme. Si foshnje nëna ime më ka hapur llogari bankare, ku kishte deponuar një shumë të parave që ishin grumbulluar si dhurata për lindjen time. Pastaj kur fillova të rritem, unë kam grumbulluar në mënyrë argëtimi duke mbushur arkën që kisha. Mandej ndryshoi loja, paratë që mi jepnin kur merrja nota të mira në shkollë apo ndonjë festë, ato i kurseja duke garuar me vëllain se cili do ta mbushte arkën më shpejt. Gjithashtu pjesa tjetër e kursimeve ishte nga nëna ime. Çdo herë na thoshte që kurseni sot e kur të keni datëlindjen, nëse ne nuk kemi mundësi të ju blejmë ndonjë dhuratë që ju dëshironi, atëherë ju keni para dhe ia plotësoni dëshirën vetes tuaj. Edhe pse paratë tona nuk i ka harxhuar, por ne që të kursejmë sa më shumë për një të ardhme më të mirë. Por tash që jam më i rritur dhe po i kuptoj gjërat më ndryshe, unë prapëseprapë kursej por me një qëllim tjetër, "që të kursejmë sot nga pak, por për qëllime të mëdha në të ardhmen".

Sepse me kursimet që grumbulloj sot, unë do ta kem më lehtë t'i plotësojë dëshirat dhe ëndrrat që kam për të ardhmen.

Ne fillimisht jemi të vegjël dhe rritemi gradualisht po ashtu edhe dëshirat dhe ëndrrat që kemi vazhdimisht ndryshojnë.

Edhe qëllimi i kursimeve ka ndryshuar dhe po ndryshon vazhdimisht, duke kursyer nga pak për qëllime të mëdha.

Më herët kishim më pak dëshira dhe ëndrra, por tash duke u rritur edhe dëshirat tona po rriten sikurse kursimet tona. Kështu që kursimet që i kam grumbulluar deri më tani, nuk janë vetëm nga ana ime si fëmijë, por kursimet janë edhe nga nëna ime e dashur.

Nëna ime prej se më ka hapur llogari bankare në fëmijëri, ajo ka ndarë, dhe ende na ndanë nga një pjesë e pagës në llogarinë time dhe të vëllait. Ajo kursen me një formë shumë interesante, që në fillim të këtij viti ku hymë në pandemi, na ka treguar neve. Nëna thotë, se paga të cilën e marrim duhet ta dimë si ta përdorim dhe ta kursejmë, d.m.th. 50 % e pagës duhet të shpenzohet për nevojat ekzistuese: ushqim, veshmbathje, libra dhe gjërat që na nevojiten gjatë muajit; 30% e pagës duhet për raste emergjente, këtë e kam kuptuar më së miri tash që jemi ende në një kohë pandemie, se sa është e rëndësishme të kemi para të kursyera. Fillimisht na nevojiteshin të blejmë gjëra ushqimore më shumë, sepse u detyruam të mbyllemi për disa muaj si dhe blerjen e barërave të cilat ishin të nevojshme. Me këtë rast e kam kuptuar më mirë se çka do të thotë nëna ime se një pjesë duhet të lihet për emergjencë, dhe 20% për dëshira. Por dëshirat e nënës si duken janë të gjitha për fëmijët, ashtu e kam kuptuar unë. Normalisht kjo llogaritje varet edhe sa para marrin prindërit tanë. Por është një mënyrë shumë e mirë edhe për ata që kanë para por i harxhojnë pa kontroll. Kjo i ka ndihmuar edhe vëllait tim, sepse ai tashmë është më i madh se unë, dhe çdo herë aq para sa kishte i harxhonte të gjitha. Pra vëllai im tash i ndan në mënyrë të vet, kursen edhe nga ato pak që i ka. Unë e sqarova edhe më herët, se qëllimet për realizimin e kursimeve kanë ndryshuar me ndryshimin tonë që ne po rritemi.

Por në këtë moshë që jam, unë mendoj që qëllimi kryesor që unë përqipem ta realizoj me paratë që kam kursyer, dhe në qoftë se kam mundësi prapë të kursej deri në studime, është që të kryej studimet pa pasur vështirësi në para, të mos më mbeten në gjysmë studimet., si dhe të punësohem në drejtimin që unë mendoj të studioj. Pastaj duke punuar e kursyer nga pak, t'i realizoj edhe dëshirat tjera që unë kam për të ardhmen. Të blej ndonjë veturë, dhe t'i vizitoj vendet të cilat kam shumë dëshirë dhe ëndërr ti realizoj. Vendet që më pëlqejnë janë: Egjipti, Anglia dhe disa vende të cilat janë më pak të njohura për ne dhe që janë më pak të vizituara. Gjithashtu më pëlqejnë edhe vendet të lashta parahistorike, vende argëtuese, etj.

Mënyrën time të veprimit "kursime të vogla për qëllime të mëdha" mendoj se jam duke e realizuar në mënyrën e duhur.

Andaj kërkohet që sa më shumë të kemi njohuri ne fëmijët për paratë qysh në fillim të vitit shkollor, që të kuptojmë më mirë dhe më herët rëndësinë e parasë për të kursyer. Pra nëse nuk keni kursyer deri tani, nuk është vonë që të filloni sot të kurseni për një të ardhme më të mirë. Nëse nuk mundemi t'i realizojmë dëshirat që kemi, së paku do të mund t'i blejmë vetes ndonjë dhuratë sa do e vogël që të jetë, dëshira e fëmijëve për dhurata është e madhe.

Ne duhet të kursejmë që t'i realizojmë qëllimet dhe dëshirat tona, prandaj të fillojmë sa më parë me kursime të vogla për qëllime të mëdha.



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Rr. Garibaldi nr.33, Prishtinë, Kosovë
+383 38 222 055
www.bqk-kos.org